



SHKURT 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI  
Raport Mujor

Mars 2015

Prill 2015

Maj 2015

Qershor 2015

Korrik 2015

Gusht 2015

Shtator 2015

Nëntor 2015

Dhjetor 2015

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shkurt 2015

© Ministria e Financave, 2015

Drejtoria e Analizave dhe Planifikimit Makroekonomik  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [marsed.harizi@financa.gov.al](mailto:marsed.harizi@financa.gov.al)  
[eva.doda@financa.gov.al](mailto:eva.doda@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

## Veçoritë Kryesore


- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin shkurt 2015 arriti në 121.40 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin shkurt 2015 ishte 2.4 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin janar 2015 ishte 123.46 Lekë për Dollarë dhe 140.23 lekë për Euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit shkurt 2015 shënuan kuotat 1.57 për ato 12 - mujore, 1.25 për 6 - mujoret ,0.90 për qind për depozitat 3 - mujore dhe 1.51 për depozitat 1 - mujore;
- *Normat e interesit për huatë në Lekë* ishin 7.36 për qind për huatë 12 - mujore dhe 8.17 për ato 6 - mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,192.7 miliardë Lekë në muajin shkurt, duke shënuar një rënie prej rreth 4.5 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për vitin 2014 rezultoi me një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 50.8 milionë Euro;
- *Situata Buxhetore* për muajin janar - shkurt 2015 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 5.8 miliardë Lekë, që do të thotë se rreth 148% më pak se planifikimi progresiv mujor (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 12.1 miliardë Lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar - shkurt 2015, arritën në rreth 51.5 miliardë Lekë, ose afërsisht 97.3 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 57.3 miliardë Lekë ose 88 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin shkurt 2015 pësoi rritje prej 2.4 për qind krahasuar me muajin janar 2015, kur ky indeks shënonte rritje prej 1.4 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit dhjetor 2014, ky indeks ishte 0.7 për qind më i lartë se në muajin nëntor 2014. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë ishin rritje me 1.4 për qind, rritje me 0.8 për qind dhe rritje me 1.7 për qind.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria me kontribut më të lartë në inflacionin e përgjithshëm në muajin shkurt e pati "Shërbimi arsimor" me një rritje vjetore të çmimit prej **10.2** për qind, duke kontribuar me **0.2** pikë përqindje. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit shkurt u konstatua në kategorinë "Shëndeti" me 4.4 për qind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bënë që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta.



mbi normën e inflacionit me rreth 0.2 pikë përqindje.

Norma vjetore e inflacionit në muajin janar arriti në 2.4 për qind, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2014 dhe janar 2015 paraqiten në tabelën 1.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2014</b>	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	1.5
<b>2015</b>	1.4	<b>2.4</b>				


VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2014</b>	1.8	2.0	1.5	1.4	1.7	0.7
<b>2015</b>						

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të Lekut kundrejt Euros në muajin shkurt 2015, arriti në 140.23 Lekë/Euro, duke shënuar rritje me 0.19 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit shkurt, një euro u këmbye me 140.36 Llekë. Kursi mesatar i këmbimit të Lekut kundrejt Dollarit amerikan në muajin shkurt 2015, arriti në 124.96 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 2.73 për qind kundrejt muajit janar 2015. Në fund të muajit shkurt, kursi i këmbimit për Dollarin amerikan arriti në nivelin 124.96 Lekë/Dollarë.

Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj Dollarit amerikan në masën 20.1 për qind, ndërsa është mbiçmuar kundrejt monedhës europiane Euro në masën 0.07 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i Lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të Euros me Dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 0.880 Dollarë/ Euro.



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Shkurt 2015**


Burimi: Banka e Shqipërisë

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitetet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit shkurt 2015, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.57 për qind, duke shënuar rritje me 0.15 pikë përqindje krahasuar me muajin janar 2014. Rritje për këtë muaj kanë pësuar gjithashtu normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 6 edhe 3-mujore respektivisht me 0.03 dhe 0.13 pikë përqindje, duke shkuar në 1.25 dhe 0.90 për qind. Norma e interesit e depozitave me afat të maturimit një muajor pësoi rënie me 0.01 pikë përqindje, duke shkuar në nivelin 1.51 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore.

Fig-3




**Normat e interesit për depozitat (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit shkurt pësoi rënie me 0.40 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 7.36 për qind nga 7.76 për qind që ishte në muajin janar 2015. Gjithashtu norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rënie me 0.04 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin shkurt arriti në 8.17 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të huave me afate maturimi 12 dhe 6 mujore kanë shënuar rënie.

Fig-4




**Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë


Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit shkurt 2015, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.58, 3.23 dhe 3.19 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rritje në *yield*-in e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12-mujore me 0.08 pikë përqindje, asnjë ndryshim në *yield*-in e bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor dhe rënie me 0.04 pikë përqindje për ato 3-mujore.

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për vitin 2014 regjistroi një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 50.8 milionë Euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. Kontributin më të madh në të e jep zëri i “Llogaria korrente” së bashku me nënzërat e saj, me -1,303.20 milionë Euro, duke u rritur në vlerë absolute me 26.9% krahasuar me vitin 2014. “Llogaria kapitale dhe financiare” për vitin 2014 rezultoi të jetë me një deficit prej 869.6 milionë Euro, ose gati 5.6% më e ulët se në vitin 2013.




Kompozicioni i llogarisë korrente prej -1,303.20 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2014: (i) bilanci tregtar -1,303.2 mln Euro, (ii) shërbime neto 268.4 mln Euro, (iii) të ardhura neto -159.6 mln Euro, (iv) transferta neto 724.6 mln Euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.



## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit shkurt 2015, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 62.3 miliardë Lekë krahasuar me muajin shkurt të vitit 2014. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 40.3 miliardë Lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 21.9 miliardë Lekë.

Fig-7




**Ecuria e M.V.N. të sistemit në Shkurt '14 - Shkurt '15**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në muajin shkurt 2015 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 4.7 miliardë Lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin janar 2015. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 6.1 miliardë Lekë. Ndërsa mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë kanë pësuar rënie gjatë këtij muaji krahasuar me një vit më parë me rreth 1.3 miliardë Lekë.

Fig-8




**Agregati M3 Shkurt '14 - Shkurt '15**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin shkurt 2015 arriti në 556,699.4 miliardë Lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me shkurt 2015 shënoi rritje me vlerë 15,956 miliardë Lekë, pra rritje prej rreth 3 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 58.4 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 325,293 milionë Lekë. Gjatë muajit shkurt 2015, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.1 për qind ose 367,939 milionë Lekë , ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 27.42 për qind ose 152,621 milionë Lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.91 dhe 1.44 për qind apo 27,331 dhe 8,042 milionë Lekë.

Fig-9




**Rritja e stokut total të kredive**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin shkurt 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 55.02 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.59 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 9.69 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.97 për qind dhe rreth 23.02 për qind.

Fig-10




**Përberja e kredive Shkurt '15**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin shkurt 2015 shënoi rritje prej 0.3 për qind krahasuar me muajin paraardhës janar 2015. Kjo ofertë arriti në rreth 1,192,174.7 milionë Lekë në fund të muajit shkurt 2015 duke shënuar një rënie prej 4,166 milionë Lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin janar 2015. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 4.5 për qind, duke shënuar kështu rritjen më të madhë përgjatë 12-mujorit të fundit.

Fig-11




**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar rënie prej 7.3 miliardë Lekë në krahasim me muajin shkurt 2014. Depozitat në valutë gjatë muajit shkurt 2015 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.5 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 86.6 për qind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit shkurt 2015, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në Lekë, me rreth 87.6 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.7 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 2 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.5% për qind dhe rreth 11.8% për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 86.6 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 843.7 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 974.8 miliardë Lekë në muajin shkurt 2015. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (104.4 miliardë), “Korporata jofinanciare publike” (17.8 miliardë) dhe “Korporata të tjera financiare” (7.2 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.5 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit shkurt 2015, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi një rritje prej 1.9 miliardë Lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në lekë me rreth 1.3 miliardë Lekë dhe depozitave në valutë me rreth 5 miliardë Lekë.

Fig-14



**Përberja e depozitave Shkurt 2015**

Burimi: Banka e Shqipërisë

# Sektori Fiskal


## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - shkurt 2015 janë mbledhur rreth 51.5 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 57.3 miliardë Lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 46.3 miliardë Lekë në shpenzime korrente dhe 3.6 miliardë Lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 74.1% janë financim i jashtëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 97.3% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 88% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 90.7% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 65.3% të tij.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 35.6 miliardë Lekë (ose rreth 120.3% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 1.1 miliardë Lekë (ose rreth 56.8% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 11.9 miliardë Lekë (ose rreth 103.4% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 4 miliardë Lekë (ose rreth 109.6% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 46.4 miliardë lekë, 11.3 miliardë Lekë (24.3% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 6.3 miliardë Lekë (13.6%) për



interesat, 2.9 miliardë Lekë (6.3%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 122 milionë Lekë (0.3%) për subvencione, 20.4 miliardë Lekë (43.9%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 3.2 miliardë Lekë (7%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 2.2 miliardë Lekë (4.7%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 14.8% (shpenzime personeli), 12.8% (shpenzime për interesat), 7.4% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 6.9% (subvencione), 14.2% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 7.9% dhe 8.8% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 3.1%, ndërsa financimi i huaj është 7% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - shkurt 2015 ishin rreth 51.5 miliardë Lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 46.5 miliardë Lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 4 miliardë Lekë.

Tab - 2 Të ardhurat gjatë periudhës janar - shkurt 2015 (mld Lekë)

Burimi	shk'15	shk'14	Ndryshimi në (%)
TVSH	18.9	19.2	-1.6
Tatimi mbi fitimin	2.1	2.4	-12.5
Taksa doganore	0.74	0.79	-6.3
Taksat nacionale	4.6	4.8	-4.1
Akcizat	4.4	3.7	18.9
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	4.0	4.6	-13.0

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: shkurt - 2015

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 5.8 miliardë Lekë, për periudhën janar - shkurt 2015, u mbështet nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 94.4% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishte huaja afatgjatë mjeti kryesor (rreth 185.5% të totalit të deficitit).

Për muajin shkurt 2015, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 26,069 miliardë Lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 34,341 miliardë Lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin shkurt 2015, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 23.9 miliardë Lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 25.3 miliardë Lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 1.9 miliardë Lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1		Indeksi i Çmimeve të Konsumit Consumer Price Index																	
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
Janar	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	1.4	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	January
<b>Shkurt</b>	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	<b>2.4</b>	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	<b>1.9</b>	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	<b>2.3</b>	<b>February</b>
Mars	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5		0.71	1.00	0.80	0.77	0.90		4.1	4.3	1.0	2.4	2.2		March
Prill	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6		0.42	0.60	0.58	0.55	0.53		3.7	4.1	1.6	2.3	1.7		April
Maj	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1		0.10	0.26	0.32	0.24	0.20		3.3	4.2	1.9	2.1	1.6		May
Qershor	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7		-0.04	0.04	0.12	0.15	0.05		3.2	3.9	2.2	2.3	1.5		June
Korrik	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6		-0.10	-0.07	0.08	-0.03	-0.04		3.4	3.6	2.7	1.6	1.8		July
Gusht	0.8	0.3	0.4	-0.1	0.1		0.01	-0.02	0.12	-0.04	-0.03		3.5	3.1	2.8	1.2	2.0		August
Shtator	0.7	0.4	0.2	0.8	0.3		0.09	0.02	0.13	0.06	0.01		3.4	2.8	2.6	1.7	1.5		September
Tetor	0.2	0.4	0.2	0.1	0.1		0.10	0.06	0.14	0.05	0.02		3.0	3.0	2.4	1.7	1.4		October
Nëntor	0.2	0.1	0.2	-0.5	-0.2		0.11	0.06	0.14	0.01	0.00		2.8	2.9	2.5	1.0	1.7		November
Dhjetor	2.2	1.0	0.9	1.7	0.7		0.28	0.14	0.20	0.15	0.06		3.4	1.7	2.4	1.9	0.7		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

**Tab - 2** **Kursi i këmbimit**  
Exchange rat Lekë për njësi të monedhës së huaj (*Lek per unit of foreign currency*)

Monedha	2010	2011	2012	2013	2014	2015		Currency
						Jan	Feb	
<i>Mesatarja e periudhës</i>								
USD	103.94	100.90	108.18	105.67	113.64	120.73	123.46	Average of period USD
EURO	137.79	140.33	139.04	140.27	140.11	140.04	140.23	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>								
USD	104.00	107.54	105.85	101.86	115.23	123.35	124.96	In the end of period USD
EURO	138.77	138.93	139.59	140.20	140.14	139.72	140.36	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 3** **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**  
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2010	2011	2012	2013	2014	2015		In percent
						Janar Jan	Shkurt Feb	
<b>Norma e depozitave</b>								
12-M	6.07	5.87	5.38	4.17	1.51	1.42	1.57	12-M Deposits rates
6-M	5.16	4.87	4.50	3.40	1.16	1.22	1.25	6-M
3-M	4.42	4.22	3.83	2.72	0.83	0.77	0.90	3-M
1-M	4.70	4.39	3.62	2.79	1.47	1.52	1.51	1-M
<b>Norma e huasë</b>								
12-M	11.52	11.17	10.28	9.52	7.00	7.76	7.36	12-M Lending rates
6-M	11.69	12.28	10.61	9.59	8.18	8.21	8.17	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>								
Bono thesari 1/								Securities rates Treasury bills 1/
3-M	5.29	5.31	5.03	3.40	3.15	3.23	3.19	3-M
6-M	6.41	6.23	5.65	3.54	3.16	3.23	3.23	6-M
12-M	7.09	6.95	6.37	3.66	3.33	3.50	3.58	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2015

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>26,683</b>	<b>51,491</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
<b>I.</b>	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>256</b>	<b>915</b>	<b>Grants</b>
<b>II.</b>	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>22,870</b>	<b>46,544</b>	<b>Tax Revenue</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>15,770</b>	<b>39,580</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	9,896	18,889	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	393	2,051	Profit Tax
3	Akcizat	1,779	4,359	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	1,919	3,997	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	1,434	3,540	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	349	744	Customs Dues
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>540</b>	<b>1,119</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	388	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	5	9	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	340	722	Local Taxes
<b>II.3</b>	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>6,560</b>	<b>11,845</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	4,734	8,853	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,687	2,684	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	139	308	Revenues for property compensation
<b>III.</b>	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,567</b>	<b>4,032</b>	<b>Non-tax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,139	3,226	Income of budgetary institutions
3	Dividenti			Divident
4	Tarifat shërbimeve	214	375	Tariffs on services
5	Të tjera	204	431	Other/not allocated
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>22,913</b>	<b>57,255</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
<b>I.</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>21,098</b>	<b>46,432</b>	<b>Current Expenditures</b>
<b>1.1</b>	<b>Personell</b>	<b>5,474</b>	<b>11,301</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Pagë	4,764	9,767	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	710	1,534	Social insurance contributions
<b>1.2</b>	<b>Interesat</b>	<b>2,984</b>	<b>6,294</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,606	5,354	Domestic
2	Të Huaja	378	940	Foreign
<b>1.3</b>	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>882</b>	<b>2,927</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
<b>1.4</b>	<b>Subveclonet</b>	<b>53</b>	<b>122</b>	<b>Subsidies</b>
<b>1.6</b>	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>9,875</b>	<b>20,382</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	7,874	15,911	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,001	4,471	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve			Expenditures for Owners Compensation
<b>1.7</b>	<b>Shpenzime për Buxhetin Vendor</b>	<b>1,127</b>	<b>3,239</b>	<b>Local budget expenditure</b>
<b>1.8</b>	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>703</b>	<b>2,167</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	59	116	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	655	2,080	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-11	-29	Compensation for ex-political prisoners
<b>III</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,584</b>	<b>3,569</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	102	925	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,482	2,644	Foreign financed
<b>IV.</b>	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>231</b>	<b>7,254</b>	
1	Detyrimet e infrastruktures	211	4,668	
2	Detyrimet tatimore			
3	Të tjera	20	2,586	
	<b>DEFICITI</b>	<b>2,770</b>	<b>-5,764</b>	<b>CASH BALANCE</b>
	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,770</b>	<b>5,764</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
	<b>Brendshëm</b>	<b>-3,825</b>	<b>-3,247</b>	<b>Domestic</b>
	Të ardhura nga privatizimi	4	28	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	4,868	5,441	Domestic new borrowing (net)
	Nacionale	4,877	5,452	Other
	Lokale	-9	-11	Foreign
	Të tjera	-8,697	-8,716	Other
	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-8,020	-6,497	Government deposits into the Central Bank
	Të tjera	-679	-2,219	Other
	Depozita e ISH dhe ISKSH	2,258	1,219	Deposits of Social and Health insurance
	Mjete në ruajtje	168	17	Preservation stock
	Nënhua	58	118	On-Loan Principal
	Detyrim ndaj ISH	2,785	2,525	Liabilities to SSI
	Të tjera (detyrime të përkoreshme)	605	545	Other-Float
	<b>I huaj</b>	<b>1,055</b>	<b>9,011</b>	<b>Foreign</b>
	Hua afatgjatë(e marrë)	1,223	1,771	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	406	413	
	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-34	Change of stat. Account
	Rpagesat	-839	-1,646	Repayments
	Mbështetje Buxhetore	665	8920	Budgetary Support

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2015**

Table of investments 2015

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar January	Shkurt Feb	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>102</b>	<b>925</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	<i>6.44</i>	<i>25.93</i>	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,482</b>	<b>2,644</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	<i>93.56</i>	<i>74.07</i>	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>1,584</b>	<b>3,569</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	<i>100</i>	<i>100</i>	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2015 (CUSTOMS REVENUES 2015)**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar January	Shkurt Feb	
Taksë doganore	349	744	Customs Duties
TVSH	5,805	12,386	V.A.T
Akcizë	1,779	4,359	Excises
Të tjera	209	412	Others
<b>TOTALI</b>	<b>8,142</b>	<b>17,901</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2014 (TAX REVENUE )**

TVSH	4,091	6,503	V.A.T
Akciza	0	0	Excises
Tatim mbi fitimin	393	2,051	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,919	3,997	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	1,225	3,128	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>7,628</b>	<b>15,679</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>15,770</b>	<b>33,580</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2015

The Deficit and Its Financing for 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leke)

	Janar January	Shkurt Feb	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>25,683</b>	<b>51,491</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>22,913</b>	<b>57,255</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>2,770</b>	<b>-5,764</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-2,770</b>	<b>5,764</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-3,825</b>	<b>-3,247</b>	<b>Domestic</b>
a. Bono Thesari Neto	793	2,101	Treasury bills
b. Obligacione	3,000	2,606	Bonds
c. Ndryshimi i gjëndjes së arkës	-5,762	-5,278	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-8,020	-6,497	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	168	17	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	4	28	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-1,139	-2,005	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-9	-11	Local Borrowing
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>1,055</b>	<b>9,011</b>	<b>Foreing</b>
a. Hua afatgjatë	1,223	1,771	Long-term foreign borrowing (gross)
nga e cila: nën-hua	406	413	
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	6	-34	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-839	-1,646	Repayments
Mbeshtetje Buxhetore	665	8,920	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2012	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	6M_I 2014	3M_III 2014	9M_2014	3M_IV 2014	Viti 2014	
<b>Llogaria korente</b>	<b>-1,021.40</b>	<b>-1,026.70</b>	<b>-271.50</b>	<b>-341.00</b>	<b>-612.50</b>	<b>-313.20</b>	<b>-925.70</b>	<b>-377.50</b>	<b>-1,303.20</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-1,999.20</b>	<b>-1,729.30</b>	<b>-426.20</b>	<b>-511.40</b>	<b>-937.60</b>	<b>-560.70</b>	<b>-1,498.30</b>	<b>-638.30</b>	<b>-2,136.60</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	1,525.60	1,731.50	212.40	264.90	477.30	228.80	706.10	219.20	925.30	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,524.80	-3,460.80	-638.60	-776.30	-1,414.90	-789.50	-2,204.40	-857.50	-3,061.90	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>195.20</b>	<b>8.90</b>	<b>30.00</b>	<b>38.10</b>	<b>68.10</b>	<b>97.90</b>	<b>166.00</b>	<b>102.40</b>	<b>268.40</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	1,655.10	1,655.00	396.40	487.10	883.50	610.00	1,493.50	538.00	2,031.50	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,459.90	-1,646.10	366.40	449.00	815.40	512.10	1,327.50	435.60	1,763.10	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-89.10</b>	<b>-8.40</b>	<b>-20.60</b>	<b>-43.30</b>	<b>-63.90</b>	<b>-48.70</b>	<b>-112.60</b>	<b>-47.00</b>	<b>-159.60</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	204.30	193.30	28.70	25.80	54.50	28.30	82.80	27.80	110.60	Income Credit
Të ardhurat Debi	-293.40	-201.70	-49.30	-69.10	-118.40	-77.00	-195.40	-74.80	-270.20	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>871.70</b>	<b>702.10</b>	<b>145.30</b>	<b>175.60</b>	<b>320.90</b>	<b>198.30</b>	<b>519.20</b>	<b>205.40</b>	<b>724.60</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	846.70	681.40	172.60	204.40	377.00	230.60	607.60	244.20	851.80	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	25.00	20.70	-27.30	-28.80	-56.10	-32.30	-88.40	-38.80	-127.20	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>81.30</b>	<b>47.70</b>	<b>22.50</b>	<b>22.40</b>	<b>44.90</b>	<b>20.70</b>	<b>65.60</b>	<b>21.10</b>	<b>86.70</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>786.00</b>	<b>775.60</b>	<b>-161.90</b>	<b>-184.20</b>	<b>-346.10</b>	<b>-363.00</b>	<b>-709.10</b>	<b>-247.20</b>	<b>-956.30</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	727.20	893.10	-168.00	-150.40	-318.40	-253.50	-571.90	-229.40	-801.30	Direct Investment
Investime portofoli	-24.50	-103.70	14.50	14.00	28.50	-12.40	16.10	104.70	120.80	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	95.90	-13.80	-8.40	-47.80	-56.20	-97.10	-153.30	-122.50	-275.80	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>231.00</b>	<b>315.30</b>	<b>49.90</b>	<b>104.20</b>	<b>154.10</b>	<b>86.40</b>	<b>240.50</b>	<b>70.50</b>	<b>311.00</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>-77.20</b>	<b>111.90</b>	<b>-37.20</b>	<b>-30.20</b>	<b>-67.40</b>	<b>156.90</b>	<b>89.50</b>	<b>-38.70</b>	<b>50.80</b>	<b>Overall Balance</b>
Rezervat	-77.20	-104.40	-40.30	22.50	-17.80	154.00	136.20	-39.00	97.20	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-12.60	-7.80	-3.20	52.80	49.60	-2.90	46.70	-0.30	46.40	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015		Millions of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Mjetet valutore neto	252,827.9	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	304,919.7	310,980.2	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	274,628.2	276,475.7	288,142.1	294,111.3	318,940.2	332,347.1	346,806.1	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	21,800.3	20,817.8	21,602.1	19,913.2	26,841.9	27,427.4	35,825.9	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	72,244.4	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	75,655.1	81,729.0	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	57,937.1	57,098.0	55,145.6	44,503.1	55,198.3	45,767.4	54,418.0	
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	66,928.8	67,590.8	68,057.8	66,768.8	71,831.3	71,633.6	78,940.0	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	8,991.7	10,492.8	12,912.2	22,265.7	16,633.0	25,866.2	24,522.0	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	28,110.7	25,602.4	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	37.3	41.5	41.4	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,771.7	1,908.5	1,911.7	1,835.8	1,741.7	1,735.5	1,730.2	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	283,453.5	289,809.0	297,721.9	308,073.7	332,899.3	331,487.2	342,191.5	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë Huatë	625.3	2,432.0	1,125.1	787.9	1,093.8	957.1	1,039.3	Deposits not included in broad money Loans
Llogari të pagueshme	797.9	901.1	1,306.1	1,309.8	14.8	26.1	8.9	Other accounts payable
Të tjera neto	-12,051.3	-12,984.4	-14,702.6	-14,102.8	-15,170.5	-15,733.5	-15,983.5	Other items net
Aksione	52,246.7	59,992.0	59,947.5	45,971.3	55,786.1	63,837.9	65,515.9	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 10** **KREDIA PËR EKONOMINË**  
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015		Million of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
<b>Totali i kredisë</b>	<b>483,044.8</b>	<b>541,899.9</b>	<b>554,732.2</b>	<b>547927.6</b>	<b>559,986.7</b>	<b>557,666.5</b>	<b>556,699.4</b>	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale</b>	-	<b>147.20</b>	<b>193.9</b>	<b>256</b>	<b>777.7</b>	<b>769.0</b>	<b>767.3</b>	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	-	147.20	193.9	256	777.7	769.0	767.3	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	<b>9,373.9</b>	<b>18,678.5</b>	<b>23,780.7</b>	<b>24961</b>	<b>27,328.1</b>	<b>28,250.7</b>	<b>27,330.6</b>	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	5,022.9	8,446.2	18,474.3	20251.4	22,402.3	23,334.7	22,415.7	in Lek
Në valutë	4,351.0	10,232.3	5,306.4	4709.6	4,925.8	4,916.0	4,914.9	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare private</b>	<b>315,879.1</b>	<b>364,373.9</b>	<b>370,993.0</b>	<b>363541.2</b>	<b>372,166.5</b>	<b>368,219.1</b>	<b>367,939.3</b>	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	83,234.9	108,321.7	121,808.7	122944.7	129,429.4	126,951.2	127,328.3	in Lek
Në valutë	232,644.2	256,052.2	249,184.3	240596.5	242,737.1	241,267.9	240,611.0	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	<b>8,704.5</b>	<b>9,841.9</b>	<b>10,162.9</b>	<b>9578.2</b>	<b>8,270.3</b>	<b>8,237.2</b>	<b>8,041.6</b>	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në Lekë	2,957.0	3,364.2	4,031.7	4238.4	3,436.9	3,233.8	3,165.9	in Lek
Në valute	5,747.5	6,477.7	6,131.2	5339.8	4,833.4	5,003.4	4,875.7	in Foreign Currency
<b>Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë</b>	<b>149,087.3</b>	<b>148,858.4</b>	<b>149,601.7</b>	<b>149591.2</b>	<b>151,444.1</b>	<b>152,190.5</b>	<b>152,620.6</b>	<b>Claims to other Resident Sectors</b>
Në Lekë	65,897.5	68,499.9	70,614.1	72242.5	77,396.7	77,699.1	77,729.1	in Lek
Në valutë	83,189.8	80,358.5	78,987.6	77348.7	74,047.4	74,491.4	74,891.5	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

## OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015		Millions of LEK End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
<b>Baza monetare</b>	<b>283,453.5</b>	<b>289,809.5</b>	<b>297,721.9</b>	<b>308,073.7</b>	<b>332,899.3</b>	<b>331,487.2</b>	<b>342,191.5</b>	<b>Base Money</b>
Ndryshimi vjetor në %	-0.5	5.4	2.7	3.5	8.1	8.6	12.7	Y/Y change in %
<b>Paraja jashtë korporatave depozituese</b>	<b>195,059.0</b>	<b>194,923.4</b>	<b>192,705.1</b>	<b>198,892.7</b>	<b>217,665.6</b>	<b>215,043.4</b>	<b>217,290.4</b>	<b>Currency Outside Depository</b>
Ndryshimi vjetor në %	-6.7	-0.1	-1.1	3.2	9.4	10.3	11.9	Y/Y change in %
<b>Depozita</b>	<b>785,225</b>	<b>875,230</b>	<b>930,703</b>	<b>950,088.4</b>	<b>977,420</b>	<b>972,965.8</b>	<b>974,884.4</b>	<b>Deposits</b>
Ndryshimi vjetor në %	18.5	10.5	6.3	2.1	2.9	2.4	2.6	Y/Y change in %
<b>Agregati M1</b>	<b>275,427.3</b>	<b>276,898.3</b>	<b>281,246.6</b>	<b>295,876.5</b>	<b>353,321.7</b>	<b>346,305.1</b>	<b>349,688.4</b>	<b>M1 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	-3.2	0.5	1.6	5.2	19.4	18.6	19.7	Y/Y change in %
<b>Agregati M2</b>	<b>604,517.3</b>	<b>647,007.8</b>	<b>669,577.1</b>	<b>693,172.2</b>	<b>722,356.7</b>	<b>714,347.9</b>	<b>717,983.0</b>	<b>M2 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	4.6	7.0	3.5	3.5	4.2	3.9	4.4	Y/Y change in %
<b>Agregati M3</b>	<b>980,283.9</b>	<b>1,070,153.7</b>	<b>1,123,407.8</b>	<b>1,148,980.9</b>	<b>1,195,086.3</b>	<b>1,188,009.1</b>	<b>1,192,174.7</b>	<b>M3 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	12.5	9.2	5.0	2.3	4.0	3.8	4.5	Y/Y change in %
<b>Burimet e bazës monetare</b>								<b>Monetary Base sources</b>
Mjetet e huaja neto	252,827.8	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	304,919.7	310,980.2	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	72,244.3	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	75,655.1	81,729.0	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	57,937.1	57,098.1	55,145.6	44,503.1	55,198.3	45,767.4	54,418.0	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	28,110.7	25,602.4	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 12

## DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015		Millions of Leks End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
<b>Në lekë</b>	<b>409,459</b>	<b>452,085</b>	<b>476,872</b>	<b>494,279.5</b>	<b>504,691</b>			<b>In national currency</b>
<b>Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë</b>	<b>80,369</b>	<b>81,975</b>	<b>88,541</b>	<b>96,983.9</b>	<b>135,656</b>	<b>131,262</b>	<b>132,398</b>	<b>Transferable deposits+Liquid deposits</b>
Qeveria lokale	948.1	1,157.4	1,059.7	1,305.0	2,047.5	1,391.4	1,392.3	Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,134.0	7,303.4	7,168.0	6,108.2	9,799.5	8,354.8	9,270.5	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	920.6	532.5	1,789.2	937.0	1,919.8	1,274.1	856.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	22,505.0	20,681.5	24,716.6	24,244.0	38,198.6	35,599.7	34,977.6	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	48,860.8	52,300.1	53,807.9	64,389.7	83,690.6	84,641.7	85,900.9	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>329,090</b>	<b>370,110</b>	<b>388,331</b>	<b>397,295.6</b>	<b>369,035</b>	<b>368,043</b>	<b>368,295</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale	55.1	109.6	19.4	57.1	7.8	18.8	15.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,054.3	2,608.9	1,715.4	1,257.8	1,167.9	1,083.2	585.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,773.4	1,423.5	2,224.4	2,556.5	1,730.1	1,893.8	1,762.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	8,316.8	11,292.5	10,954.1	14,523.4	11,772.0	11,497.7	13,457.9	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	315,890.5	354,675.1	373,417.3	378,900.8	354,357.3	353,549.3	352,473.0	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>375,767</b>	<b>423,146</b>	<b>453,831</b>	<b>455,808.9</b>	<b>472,729</b>	<b>473,661</b>	<b>474,192</b>	<b>In foreign currency</b>
Qeveria lokale	493.0	280.5	44.5	372.6	231.3	102.8	120.5	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,201.0	5,242.2	4,011.2	4,486.2	7,099.6	7,612.5	8,010.5	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	8,572.0	6,022.3	6,303.3	6,673.1	4,872.9	4,428.5	4,603.1	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	57,382.9	54,418.4	46,867.5	49,382.3	55,834.3	56,871.4	56,034.9	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	303,117.7	357,182.4	396,604.2	394,894.7	404,691.2	404,646.1	405,422.7	Other resident sectors
<b>Totali</b>	<b>785,225</b>	<b>875,230</b>	<b>930,703</b>	<b>950,088.4</b>	<b>977,420</b>	<b>972,965.8</b>	<b>974,884.4</b>	<b>Total</b>
Qeveria lokale	1,496.2	1,547.5	1,123.6	1,735	2,286.6	1,513.0	1,528.6	Local governments
Korporata jofinanciare publike	16,389.3	15,154.5	12,894.6	11,852.2	18,067.0	17,050.5	17,866.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,266.0	7,978.3	10,316.9	10,166.6	8,522.8	7,596.4	7,222.2	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,204.7	86,392.4	82,538.2	88,149.7	105,804.9	103,968.8	104,470.4	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	667,869.0	764,157.6	823,829.4	838,185.2	842,739.1	842,837.1	843,796.6	Other resident sectors

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015		Millions of Lek End of period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
<b>AKTIVET</b>	<b>368,032</b>	<b>384,581</b>	<b>394,834</b>	<b>398,814</b>	<b>433,878</b>	<b>450,092</b>	<b>469,195</b>	<b>ASSET</b>
<b>Total</b>	<b>50,480</b>	<b>48,572</b>	<b>48,288</b>	<b>40,652</b>	<b>51,880</b>	<b>61,185</b>	<b>69,219</b>	<b>Total</b>
Mbajtjet e SDR	8,126.9	8,226.5	8,789.7	10,508.0	19,299.7	20,589	28,614	SDR holdings
Arka në valutë	647.0	59.8	67.5	57.3	56.2	21.4	138.9	Foreign currency
Depozitat	41,705.7	40,286	39,431.1	30,086.2	32,524.0	40,574.3	40,466.6	Deposits
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	<b>280,301</b>	<b>284,210</b>	<b>294,007</b>	<b>308,387</b>	<b>320,745</b>	<b>324,262</b>	<b>329,749</b>	<b>Securities other than shares</b>
Jorezident	215,901.8	219,718.8	229,313.1	243,178.6	256,796.7	260,519	266,085	nonresidents
Qeveria qendrore	64,399.2	64,490.8	64,694.1	65,208.4	63,947.9	63,742.8	63,663.5	central government
<b>Huatë</b>	<b>14,302</b>	<b>27,388</b>	<b>23,707</b>	<b>23,333</b>	<b>27,286</b>	<b>29,843</b>	<b>27,329</b>	<b>Loans</b>
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,534.8	25,485.4	21,800.2	21,502.3	25,547.8	28,111	25,602	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,767.3	1,902.8	1,906.5	1,830.9	1,738.5	1,732.0	1,726.2	Other resident secotrs
<b>Derivatet financiare</b>	<b>81.4</b>	<b>35.3</b>	<b>14.2</b>	<b>31.5</b>	<b>17.4</b>	<b>20.8</b>	<b>35.1</b>	<b>Financial derivatives</b>
<b>Llogari të arketueshme</b>	<b>10,748.3</b>	<b>11,295.9</b>	<b>14,129.2</b>	<b>11,994.1</b>	<b>18,197.8</b>	<b>18,584.3</b>	<b>26,811.9</b>	<b>Receivable accounts</b>
<b>Mjetet jofinanciare</b>	<b>12,119.1</b>	<b>13,080.0</b>	<b>14,688.0</b>	<b>14,416.4</b>	<b>15,752.1</b>	<b>16,198.1</b>	<b>16,051.5</b>	<b>Nonfinancial assets</b>
<b>DETYRIMET</b>	<b>368,032</b>	<b>384,581</b>	<b>394,834</b>	<b>398,814</b>	<b>433,878</b>	<b>449,770</b>	<b>469,195</b>	<b>LIABILITIES</b>
<b>Total</b>	<b>202,644</b>	<b>203,009</b>	<b>201,086</b>	<b>208,042</b>	<b>226,588</b>	<b>224,140</b>	<b>226,296</b>	<b>Total</b>
Para në qarkullim	202,386.7	202,906.6	200,898.7	207,792.7	226,434.1	224,010	226,134	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	256.8	102.8	187.3	249.7	154.2	130.5	161.4	Deposits included in broad money
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjerë</b>	<b>98,842</b>	<b>108,017</b>	<b>120,691</b>	<b>132,765</b>	<b>140,569</b>	<b>150,651</b>	<b>165,262</b>	<b>Deposits excluded from broad money</b>
Jorezident	8,440.3	8,318.7	10,042.9	9,706.5	16,564.1	16,539	23,890	Nonresidents
Qeveria qendrore	8,966.2	10,465.6	12,887.1	22,239.2	16,600.5	25,807	24,437	Central government
Korporata të tjera depozituese	80,810.0	88,570.2	97,054.7	100,031.3	106,310.9	107,347	115,896	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	14.9	20.5	37.2	62.5	85.0	86	95	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	610.4	641.5	669.2	725.4	1,008.8	871	945	Other resident sectors
<b>Huatë</b>	<b>5,921</b>	<b>4,852</b>	<b>3,871</b>	<b>2,919</b>	<b>2,294</b>	<b>2,294</b>	<b>2,153</b>	<b>Loans</b>
Jorezidentët	5,920.6	4,852.0	3,870.7	2,919.3	2,294.2	2,294	2,153	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>936.4</b>	<b>1,064.3</b>	<b>1,680.5</b>	<b>1,828.3</b>	<b>886.8</b>	<b>1,096</b>	<b>1,760</b>	<b>Other accounts payable</b>
<b>Alokimi i SDR</b>	<b>7,439.5</b>	<b>7,647.1</b>	<b>7,557.9</b>	<b>7,287.5</b>	<b>7,753.2</b>	<b>8,074</b>	<b>8,209</b>	<b>SDR allocation</b>
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë</b>	<b>52,249.7</b>	<b>59,992</b>	<b>59,947.5</b>	<b>45,971.3</b>	<b>55,786.1</b>	<b>63,516</b>	<b>65,516</b>	<b>Shares and other equity</b>